

Nr. 2502/006 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 11/02/2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Z. Ilirjan CELIBASHI

Komisionit të Ankimimeve dhe
Sanksioneve

Lënda: DENONCIM Nr. 3 – Lidhur me përdorimin në postimet e aktiviteteve institucionale të ministrive të sloganeve / hashtag-eve partiakë / elektoralë: #KrenarPërShqipërinë, #VetëmPërpara dhe #Shqipëria2030.

I nderuar z. Komisioner!

Të nderuar Drejtues të Administratës së KQZ-së!

Të nderuar Anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve!

Sikurse jeni në dijeni, një nga denoncimet e përcjella nga KRIIK në KQZ përgjatë procesit të Zgjedhjeve Vendore 2023, ka qenë përdorimi i faqeve zyrtare të institucioneve në rrjetet sociale për postime me karakter elektoral.

Një nga rastet për kategorizim të tillë, i pranuar si shkelje dhe që është sanksionuar nëpërmjet vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, ishte përdorimi i hashtag-eve në postimet në këto faqe.

Pavarësisht se kjo lloj shkeljeje, në vitin 2023 u sanksionua, KRIIK **vëren me shqetësim se disa institucione vijuan t'i përdorin pas zgjedhjeve 2023, pavarësisht ndalimit të bërë.**

Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, prej nisjes së periudhës katërmujore më datë 11 janar 2025 e deri më sot, në një pjesë të konsiderueshme të **Faqeve Zyrtare në Facebook të Ministrive** në vend janë duke u përdorur **sloganet elektoralë të Partisë Socialiste**, në formën e hashtag-eve (#) dhe konkretisht:

- 1 - [#KrenarPërShqipërinë](#);
- 2 - [#VetëmPërpara](#);
- 3 - [#Shqipëria2030](#).

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Këto tre slogane/hashtag-e lidhen dhe identifikojnë drejtpërsëdrejt Partinë Socialiste me maxhorancën e deputetëve në Kuvend, e cila, megjithëse ende nuk është regjistruar zyrtarisht si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e 11 majit, e ka filluar tashmë de facto

botërisht fushatën elektorale duke kërkuar të votohet dhe mbështetet në zgjedhjet e 11 majit 2025.

Lidhur me përkatësinë e sloganeve/hashtag-eve theksohet se:

1. Slogani “KrenarPërShqiperine”, është slogan identifikues i [Partisë Socialiste në faqen e saj zyrtare në Facebook](#).

2. Slogani “VetëmPërpara”, ka qenë zyrtarisht slogani i fushatës elektorale të Partisë Socialiste gjatë Zgjedhjeve Vendore të vitit 2023. Shihni: "[Kurrë pas, vetëm përpara](#)", [PS hap fushatën për zgjedhjet e 14 Majit](#)".

3. Slogani “Shqipëria2030” është përdorur gjithashtu nga Partia Socialiste në vijim si titull i programit të saj elektorale. Konkretisht nga Kryetari i Partisë Socialiste Z. Edi Rama në Asamblenë Kombëtare Partisë Socialiste “*Sot hapim një kapitull të ri të jetës së kësaj familje. Nga ky stacion, ku do të përmbylim proceset e brendshme zgjedhore, duke ngarkuar edhe ekipin e ri drejtues, ne do të nisemi drejt përballjes për mandatin e 4 qeverisës të Partisë Socialiste, pranverën e ardhshme. Për 6 muaj duhet të jetë gati të zbresë zyrtarisht në fushë, skuadra jonë e re përfaqësuese PS 2030 për Shqipërinë 2030. (...)*”. Për më shumë shihni link-un: “[Ekip i ri për zgjedhjet e 2025 dhe 'Shqipëria 2030' Fjala e plotë e kryeministrit Edi Rama në Asamblenë e PS-së](#)”.

Përpos sa më sipër, theksohet edhe se postimet e aktiviteteve, njoftimeve apo promovimeve të ndryshme në rrjetin social *Facebook* të Kryeministrit, Ministrave, Deputetëve, Kryetarëve të Bashkive, etj., **sidomos ato me karakter partiak dhe elektorale**, shoqërohen në shumicën dërrmuese të rasteve me grupin e hashtag-eve të sipërpërmendura.

Gjithashtu, ky grup hashtag-esh shoqërojnë shumicën dërrmuese të postimeve edhe në [Faqen në Facebook të Partisë Socialiste](#).

Këto slogane duke u vendosur, përdorur dhe reklamuar nga Institucionet Publike dhe drejtuesit e tyre në Faqet Zyrtare të Institucioneve përkatëse në Facebook, në gjykimin e KRIIK, konstatojnë:

1. shpërdorimin e autoritetit shtetëror të institucioneve duke i dhënë natyrë partiake dhe elektorale, konkretisht të Partisë Socialiste; si dhe

2. shpërdorimin e burimeve shtetërore për qëllime partiake e elektorale (në dobi të Partisë Socialiste) nëpërmjet përdorimit të:

a. një aseti institucional (specifikisht të faqes zyrtare në mënyrë të institucionit në mediat sociale si kanal komunikimi publik);

b. kohës së nëpunësve shtetërorë (personat e ngarkuar me shpërndarjen e njoftimeve në këto faqe dhe mirëmbajtjen e saj);

c. gjithë burimeve publike të vëna në dispozicion për realizimin e aktivitetit institucional që publikohet / postohet, duke u dhënë valencë dhe meritë partiake në funksion të një partie politike (Partisë Socialiste), çka është në kundërshtim me

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

kuadrin ligjor zgjedhor, si dhe të parimit kushtetues për ndarjen e shtetit nga partia.

Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare në facebook e Ministrive të mëposhtme:

1. Faqja zyrtare në Facebook e [Ministrisë së Arsimit dhe Sportit](#) ;
2. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministrisë së Financave](#) ;
3. Faqja zyrtare në Facebook e [Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit](#) ;
4. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë](#) ;
5. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministrisë së Brendshme](#) ;

Të gjitha rastet e mësipërme të postimeve me përmbajtje partiake dhe elektorale në Faqet Zyrtare të Ministrive, të detajuara me link-et dhe printscreen-et përkatëse, gjenden bashkëlidhur në *Lidhjen nr. 1*, në vijim të këtij dokumenti.

KRIIK nxit KQZ-në që të marrë menjëherë masat e nevojshme që të ndalojë shkeljen si dhe të parandalojë me efektivitet përdorimin e burimeve shtetërore duke u kërkuar Institucioneve që të ndalojnë postimet me natyrë partiake / elektorale në faqet e tyre, si dhe të pastrojnë të gjithë postimet e mëparshme.

Është shqetësuese që, në kuptimin e Institucioneve, drejtuesve dhe administratës së tyre, **ndalimi i përdorimit të burimeve shtetërore** në dobi të një partie apo fushatës elektorale të saj, **vlen vetëm përgjatë fushatës zgjedhore apo gjatë periudhës katërmujore** para datës së zgjedhjeve.

Ndaj është me vend të **theksohet nga KQZ-ja se ky ndalim i shtrin efektet në çdo kohë**, pasi shpërdorimi i burimeve shtetërore për arsye partiake apo elektorale është i ndaluar në çdo kohë.

Në gjykimin e KRIIK, **Partitë Politike mundet që**, në një mënyrë apo në një tjetër, të **bëjnë fushatë gjatë gjithë kohës**, edhe jashtë periudhave parazgjedhore, **por në asnjë rast nuk duhet të bëhet kjo në dëm të Autoritetit Shtetëror të Institucioneve Publike dhe as të burimeve shtetërore** që posedojnë ato.

Vija e ndarjes së shtetit nga partia duhet të jetë e qartë, e plotë dhe duhet të mos lejojë asnjë boshllëk apo mangësi në qasjen e KQZ-së, **për të mos lënë vend për asnjë lloj keqinterpretimi apo keqkuptimi.**

Në këtë aspekt, **nxitet dhe theksohet nevoja që KQZ-ja të kërkojë** në mënyrë të qartë **fshirjen e të gjitha postimeve me natyrë partiake apo elektorale** që mund të jenë në faqet e Institucioneve, si dhe **sloganet/hashtag-et partiakë/elektoralë që shoqërojnë postimet e aktiviteteve institucionale**, pavarësisht kohës se kur janë postuar ato.

Kjo pasi është vërejtur se postime të tilla janë bërë herë pas here, madje vijojnë të jenë në faqet e tyre, që pas zgjedhjeve 2023 e deri më sot.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhur me gjithë sa më sipër, sipas gjykimit të KRIIK, **nevojitet që rastet të merren në konsideratë prej jush si KQZ**, të shqyrtohen duke ndërmarrë hetimin e nevojshëm administrativ dhe vazhduar më pas ndjekjen e procedurave të parashikuara për sanksionimin e shkelësve sipas ligjit.

Gjithashtu, në gjykimin e KRIIK, **KQZ-ja nevojitet që përpos sanksionimit të titullarëve përkatës së këtyre institucioneve sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor, të njoftojë dhe paralajmërojë me shkrim Partinë Socialiste të Shqipërisë në favor të të cilës janë kryer shkeljet e mësipërme, duke i kërkuar marrjen e masave nga ana e saj për mospërsëritjen e tyre në të ardhmen.**

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

Premto GOGO

Kryetar

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhja Nr. 1

I. FAQJA ZYRTARE E MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT NË FACEBOOK

1. [Postimi i datës 11 shkurt 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:


[#InvestimetNëArsimDheSport](#) 🏠⚽

Shkolla e rilindur “Bardhyl Pojani” hap dyert për nxënësit e Pojanit në bashkinë Maliq, një tjetër investim i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për nxënësit dhe mësuesit që tashmë mësojnë në një shkollë moderne, me ambiente të reja dhe standardet më të mira. 📖👩🏫🎓

[#KrenarPërShqipërinë](#) 🇦🇱❤️

[#VetëmPërpara](#) 🇦🇱🇦🇱

[#SHQIPËRIA2030](#) 🇦🇱🌟



2. [Postimi i datës 07 shkurt 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Lajm i mirë për inovacionin dhe shkencën 🚀💡

👩🏫👨🏫 Qendra Llogaritëse, pranë Departamentit të Fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, tashmë është pajisur me kompjuterë me performancë të lartë (High Performance Computing) për kërkime shkencore të avancuara në fusha të rëndësishme si shëndetësia 🏥, energjia ⚡, emergjencat civile 🚒 dhe më shumë 🍌

Me investimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet AKKSHI dhe me mbështetjen e CERN, ky laborator i ri hap mundësi të mëdha për kërkuesit shkencorë dhe studentët, duke i afruar ata me standardet ndërkombëtare 🎓

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇦🇱

[#VetëmPërpara](#) 🇦🇱🇦🇱

[#SHQIPËRIA2030](#) 🇦🇱🌟

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:


P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



3. [Postimi i datës 3 shkurt 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Tiranë "Qyteti Studenti" - Ky qytet gjer më dje i rrënuar, po rilind me ambicie e punë të madhe, duke shtuar rrjetin e godinave të cilësisë më të lartë, që nga dhomat e fjetjes të pajisura me duše e tualete më vete, sallat e leximit, hapësirat e gatimit e ngrënies në çdo kat, internet falas, sistem sigurie, lavanderi, si edhe duke u përgatitur për zbatimin e projekteve të një sërë godinash të reja administrative, social-kulturore e sportive 🇲🇪🇷🇪 Faleminderit edhe Delegacionit të Bashkimit Europian dhe Bankës Gjermane për Zhvillim

KfW 🇲🇪🇷🇪🇷🇪🇷🇪
[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇲🇪
[#VetëmPërpara](#) 🇲🇪🇷🇪
[#SHQIPËRIA2030](#) 🇲🇪🇷🇪🌟




Address:
 Rr. "Ymer Kurti",
 Nd.4, H.2, Ap.3,
 Nj.Adm.5,
 Tirana

Mailingaddress:
 P.O.Box. 2396
 Tirana, 1001,
 Albania

4. [Postimi i datës 3 shkurt 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Shkolla e re 🌞 “Bajram Abdiu” në Bicaj të Kukësit, e rindërtuar me standardet më të mira bashkëkohore 🏡, ka hapur dyert për nxënësit dhe mësuesit e kësaj zone, falë investimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë së Kukësit.


[#ShkollaTëReja](#) 🏡
[#VetëmPërpara](#) 🇦🇱
[#SHQIPËRIA2030](#) 🇲🇵



5. [Postimi i dates 28 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

🗣️🎧 NJË VIZITË ME PODKAST, në Departamentin e Gazetarisë të Universitetit të Tiranës, ku kemi investuar në laboratorin e mediave digjitale me teknologjinë më të avancuar, i cili do të shërbejë për praktikantët mësimorë të studentëve të gazetarisë por jo vetëm 🧑🏫🎧🎙️📹

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇦🇱
[#VetëmPërpara](#) 🇦🇱
[#SHQIPËRIA2030](#) 🇲🇵🌟





Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana


Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



6. [Postimi | dates 28 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

 Në shkollën 9-vjeçare "Ndre Mjeda" në [#Shkodër](#), një tjetër investim i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë së Shkodrës, ka nisur puna për rilindjen e saj për ta rikthyer siç i ka hije për 800 nxënës dhe mësues 


[#InvestimetNëArsimDheSport](#) 
[#KrenarëpërShqipërinë](#) 
[#VetëmPërpara](#) 
[#SHQIPËRIA2030](#) 



7. [Postimi | dates 22 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Në laboratorin e ri inteligjent të shkollës 9-vjeçare "Niko Hoxha" në Valias,  nxënësit po mësojnë si të krijojnë muzikë në SmartLab, duke kombinuar aftësitë digjitale me ato artistike! 

Integrimi i TIK në lëndë si Kimia, Biologjia, Matematika, Gjuha Shqipe, Gjuha e Huaj, etj., është pjesë e një plani të gjerë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për të kombinuar aftësitë digjitale me ato lëndore.

Mbi 16 mijë mësues po trajnohen për metodat inovative në mësimdhënie dhe aftësitë digjitale, përmes Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve, për më shumë cilësi në mësimdhënie në shkollat tona  teksa do të vijojmë investimet në laboratorë inteligjentë edhe në 615 shkolla të tjera.


[#KrenarëpërShqipërinë](#) 
[#VetëmPërpara](#) 
[#SHQIPËRIA2030](#) 

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
 Nd.4, H.2, Ap.3,
 Nj.Adm.5,
 Tirana

Mailingaddress:


P.O.Box. 2396
 Tirana, 1001,
 Albania



8. [Postimi I dates 15 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Në shkollën "Konferenca e Pezës", një prej 68 shkollave të Tiranës e pajisur me laborator inteligjent 🧑‍🔬, që po u shërben 543 nxënësve dhe mësuesve 🧑‍🏫, për zhvillimin e lëndëve si TIK 📱💡, por dhe të lëndëve të tjera, për të zhvilluar aftësitë digjitale, kreative dhe mendimit kritik tek nxënësit.

[#KrenarëpërShqipërinë](#) 🇦🇱❤️
[#VetëmPërpara](#) 🚀📖
[#SHQIPËRIA2030](#) 🇦🇱⭐



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania


9. [Postimi i dates 13 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Në shkollën "Tringe Smajli" në fshatin Grudë e Re, Shkodër, ku koduesit e vegjël po zhvillojnë aftësitë e tyre digjitale në laboratorin e ri, të pajisur me të gjitha mjetet didaktike moderne.

Deri tani, 300 laboratorë inteligjentë janë hapur në shkollat tona, duke u ofruar nxënësve mundësinë të përfitojnë njohuri të avancuara në lëndët STEM, matematikë, shkencë ekzakte, gjuhën shqipe dhe gjuhët e huaja.

Në dy vitet e ardhshme, synojmë që çdo shkollë të ketë një laborator inteligjent, duke u zgjeruar në +615 shkolla, në mënyrë që fëmijët tanë të zhvillojnë aftësitë e tyre digjitale dhe të jenë të përgatitur për sfidat e së ardhmes.

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇲🇪
[#VetëmPërpara](#) 🇲🇪🇲🇪
[#SHQIPËRIA2030](#) 🇲🇪🌟



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:


P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

II. FAQJA ZYRTARE E MINISTRISË SË FINANCAVE NË FACEBOOK

1. [Postimi i datës 6 shkurt 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Tiranë, Banka e Shqipërisë - Një skemë e re mbështetjeje financiare për bujqësinë dhe sipërmarrjen në fshat 🏡🚗
 Përmes një instrumenti bankar novator, me një linjë financimi prej 250 milionë euro, do të rrisim aksesin për kredi të buta për një nga sektorët prioritarë 🍌
 Me qeverinë si garante, do të mbështeten investimet në sera, agropërpunim, peshkim, akuakulturë, agroturizëm, inovacion teknologjik në shërbim të zhvillimit rural 🏡🚗


[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇦🇱
[#VetëmPërpara](#) ➡️🇦🇱
[#SHQIPËRIA2030](#) 🇦🇱★



2. [Postimi i datës 15 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Abu Dhabi - Fjala ime dhe e Giorgia Melonit në Samitin Global “Abu Dhabi Sustainability Week” 🇦🇪🇮🇹

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇦🇱
[#VetëmPërpara](#) ➡️🇦🇱
[#SHQIPËRIA2030](#) 🇦🇱★



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
 Nd.4, H.2, Ap.3,
 Nj.Adm.5,
 Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
 Tirana, 1001,
 Albania

III. FAQJA ZYRTARE E [MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT](#) NË FACEBOOK

1. [Postimi i datës 5 shkurt 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Tiranë - PENSIONET, Konferenca Ndërkombëtare për sfidat dhe ambiciet e reformës së re të sistemit të pensioneve për [#Shqipërinë2030](#) 🇧🇪🇩🇪🇩🇪

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇩🇪

[#VetëmPërpara](#) 🇧🇪🇩🇪

[#SHQIPËRIA2030](#) 🇩🇪🌟



2. [Postimi i datës 28 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Tiranë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit - Një dritare e re për të rinjtë krijues

Nis pranë ish-Kinostudios “Shqipëria e Re”, një nga programet më transformuese për industrinë kreative në Shqipëri, “Tirana Training Center” 🇧🇪🇩🇪🇩🇪

Kjo qendër do të shërbejë si katalizator për zhvillimin e kinematografisë dhe prodhimeve audiovizuale në Shqipëri, duke ofruar:

🎬 Trajnime profesionale për deri në 400 studentë njëkohësisht, në fusha si aktrimi, regjia, animacioni, prodhimi, shkrimi dhe më shumë 🍌

🎥 Një urë lidhëse mes industrisë krijuese dhe tregut ndërkombëtar, me pjesëmarrjen e profesionistëve nga HBO, Netflix, Ëarner Brothers, Disney, Paramount dhe të tjerë 🍌

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇩🇪

[#VetëmPërpara](#) 🇧🇪🇩🇪

[#SHQIPËRIA2030](#) 🇩🇪🌟

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



3. [Postimi I dates 22 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

300 objekte bizhuteri e veshje shqiptare në Muzeun Etnografik të Budapestit 🇲🇪

Një pasuri kulturore e jashtëzakonshme, e cila i është shitur muzeut në Budapest nga Palokë Laca në shek.XX, një personazh që po rilind në dritën e hulumtimeve të thella dhe bashkëpunimit mes Muzeut Marubi dhe muzeologëve hungarezë 🌟

🟢 Në qershor 2025, ky koleksion unik do të ekspozohet për herë të parë në Shkodër, në Muzeun Marubi, duke ofruar një mundësi të pazakontë për t'u njohur me artizanatin shqiptar dhe lidhjen e tij me kulturat e tjera 🍀

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇲🇪
[#VetëmPërpara](#) 🇲🇪🇫🇷
[#SHQIPËRIA2030](#) 🇲🇪🌟



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

4. [Postimi i datës 17 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:



5000 VENDE PUNE në Platformën Kombëtare të Punësimit <https://www.puna.gov.al/>

✓ Njihu me vendet e lira të punës çdo muaj dhe apliko 📄

📄 <https://www.puna.gov.al/>

✓ Regjistrohu në kurs formimi profesional 🧑🎓🔧


📄 <https://www.puna.gov.al/>

✓ Regjistrohu si punëdhënës dhe publiko vendet e lira të punës për të gjetur punëkërkesit e duhur 📄 <https://www.puna.gov.al/>

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇦🇱

[#VetëmPërpara](#) 🇦🇱

[#SHQIPËRIA2030](#) 🇦🇱⭐



5. [Postimi i datës 16 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Hapet rezidenca artistike, “Vila 31 x Art Explora” duke u shndërruar në një ambient të hapur e kulturor për të pritur artistët shqiptarë e të huaj për organizimin e ngjarjeve kulturore 🎨📖🎧🎤

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇦🇱

[#VetëmPërpara](#) 🇦🇱

[#SHQIPËRIA2030](#) 🇦🇱⭐

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania




6. [Postimi i dates 11 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Elbasan - Nënshkrimi i marrëveshjes për Rijetëzimin e kalasë së qytetit 🇹🇯🇵🇸

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇹🇯

[#VetëmPërpara](#) 🇹🇯🇵🇸

[#SHQIPËRIA2030](#) 🇹🇯🇵🇸



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

IV. FAQJA ZYRTARE E [MINISTRISË SE INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË NE FACEBOOK](#)


1. [Postimi I dates 04 shkurt 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Hapet thirrja e dytë për subvencionimin e 2000 familjeve për vendosjen e paneleve diellore për ngrohjen e ujit 🇲🇪🇸🇰

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇲🇪

[#VetëmPërpara](#) 🇲🇪🇸🇰

[#SHQIPËRIA2030](#) 🇲🇪🌟



2. [Postimi i datës 30 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

👷🏻👷🏻👷🏻🕒 Vijon puna për rehabilitimin e aksit rrugor, Fier-Kthesa e Patosit-Fratar, me një gjatësi prej afro 43 kilometrash 🇲🇪

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇲🇪

[#VetëmPërpara](#) 🇲🇪🇸🇰


[#SHQIPËRIA2030](#) 🇲🇪🌟

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:


P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



3. [Postimi i dates 22 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes, në rolin e lexuesve të matësve të energjisë, për të diskutuar mbi masat e marra dhe detyrat që dalin nga skema e re e faturimit të energjisë elektrike ⚡💡

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇦🇱
[#VetëmPërpara](#) 🇦🇱🇵🇸
[#SHQIPËRIA2030](#) 🇦🇱⭐



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

V. FAQJA ZYRTARE E MINISTRISË SË BRENDSHME NË FACEBOOK

1. [Postimi i datës 5 shkurt 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:


- Prononcim për mediat i Ministrit të Brendshëm [Ervin Hoxha](#) pas mbledhjes së qeverisë: Zgjedhjet e 11 Majit, zgjatet afati i vlefshmërisë së kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike. Përfitojnë 500 mijë shtetas shqiptarë. (...)

Kryeministria - VENDIMET E QEVERISË SOT

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇹🇷

[#VetëmPërpara](#) 🇪🇺🇵🇸

[#SHQIPËRIA2030](#) 🇹🇷🌟



2. [Postimi i datës 31 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

FotoAlbumi - Nga publikimi i sondazhit "Kënaqësia e publikut me punën e Policisë", financuar nga qeveria suedeze, për matjen e perceptimit qytetar mbi nivelin e sigurisë në vendin tonë dhe besimin tek [Policia e Shtetit](#) 🇹🇷🇵🇸🚓

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇹🇷

[#VetëmPërpara](#) 🇪🇺🇵🇸


[#SHQIPËRIA2030](#) 🇹🇷🌟

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:


P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



3. [Postimi i datës 31 janar 2025](#), me përshkrimin si më poshtë:

Ministria e Brendshme - Prezantohet anketimi i financuar nga qeveria suedeze, për matjen e perceptimit qytetar mbi nivelin e sigurisë në vendin tonë dhe besimit tek Policia e Shtetit. Ky anketim tërësisht i pavarur, kryhet për të gjashtën herë me iniciativën dhe nën mbikëqyrjen e qeverisë suedeze 🇸🇪👮🚓🚒

[#KrenarpërShqipërinë](#) ❤️🇦🇪
[#VetëmPërpara](#) 🇦🇪🇪🇺
[#SHQIPËRIA2030](#) 🇦🇪🌟



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania